



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

Nr/Br.

642/20

Datë/Datum.

09.10.20

PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr.642/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Bejta Commerce” SH.A – Gjilan , kundër njoftimit për dhënie të kontratës , ku është rekomanduar për kontratë OE: “Globi M.I ” SH.P.K- , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i tregut dhe parkut në Zhegër” me nr. të prok: 651-20-3398-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Gjilan” (KK.GJ), më datën: 08.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Bejta Commerce” SH.A – Gjilan , kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i tregut dhe parkut në Zhegër” me nr. të prok: 651-20-3398-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Gjilan” (KK.GJ),

II. ANULOHET, vendimi i AK-së - njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i tregut dhe parkut në Zhegër” me nr. të prok: 651-20-3398-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Gjilan” (KK.GJ), dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Bejta Commerce” SH.A – Gjilan , i aprovohet si pjesërisht e bazuar , i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Bejta Commerce” SH.A – Gjilan , si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 04.09.2020 me nr. 642/20 , kundër njoftimit për dhënie të kontratës , ku është rekomanduar për kontratë OE: “Globi M.I ” SH.P.K- , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i tregut dhe parkut në Zhegër” me nr. të prok: 651-20-3398-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Gjilan” (KK.GJ),duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 7 , 59 , 60 , si dhe nenin 69 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 14.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 24.09.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: “Bejta Commerce” SH.A – Gjilan ,

Pretendimi nr. 1, Lidhur me pretendimin e pare ankimor lidhur me validitetin e ofertës siç është kërkuar ne FDT dhe NJPK është se Validiteti i ofertës te jete 90 dite, kurse OE ankues ne dosjen e tij e ka shënuar 60 dite, qe bie ndesh me kriterin e kërkuar te AK-se.

Neni 31 i RRUOPP-se e precizon Validitetin e tenderit

Paragrafi 31.1 Autoritetet Kontraktuese duhet te cekin ne dosjen e tenderit periudhën e vlefshmërisë se tenderit te kërkuar dhe specifikuar, si numër i ditëve kalendarike, nga afati i fundit për dorëzimin e tenderëve.

31.2 Kërkesa për periudhën e validitetit të tenderit do të jetë:

- Minimum 90 dite për kontrata me vlera të mëdha;
- Minimum 60 dite për kontrata me vlera të mesme;
- Minimum 30 dite për kontrata me vlera të vogël.

Pra, kriteri i kërkuar i AK-se ka qene 90 dite, kurse OE e ka sjellë validitetit 60 dite, që nënkuptohet se nuk është përmbushur kriteri i kërkuar i AK-se si në FDT dhe NJK.

Pra, edhe neni 39.8 i RRUOPP-se thotë:

Formulari i tenderit, nuk është plotësuar siç duhet apo mungon – Refuzo tenderin pa kërkuar sqarim shtese – kusht administrativ

Pra, në këtë pikë nuk përmbushet kriteri i AK-se, sepse kriteri i kërkuar nuk është plotësuar dhe pretendimi ankimor i OE ankues është i pabazuar.

Përgjigje nr.2

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, lidhur me inxhinierin e gjeodezisë z. Izjadin Sylja, ky inxhinier është i prezantuar në dosjet e të dy OE-ve (fituesit dhe ankuesit).

Pra, në dosjet e dy kompanive OE ankues BEJTA COMMERCE dhe OE i rekomanduar GLOBI M.I, vërehet se dy OE-te e kanë inxhinierin e njëjtë.

Unë si ekspert nuk kam kompetencë dhe autoritet për të verifikuar nënshkrimet e inxhinierëve dhe Për këtë pikë AK-ja është përgjegjëse që përmes organeve kompetente të vërtetohet ajo që dyshon OE ankues.

Pra, përgjegjësia për këtë pikë i bie AK-ne, sepse kriteri është i kërkuar nga AK-ja dhe po ata janë kompetent për verifikim ose nëse ka dyshime OE ankues mund të drejtohet organeve kompetente.

Gjithashtu në dosjet e tenderit nuk ka qenë kërkesë që një inxhinier nuk mund të ketë marrëveshje bashkëpunimi me dy operator ekonomik.

Pretendimi ankimor pjesërisht i bazuar.

Përgjigje nr.3

Lidhur me pretendimin ankimor për mos respektim të nenit 1,7 të LPP-se, Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-se, sepse janë obliguar që të sigurohen që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë me ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit. Prandaj, me këtë veprim të AK-se po rrezikohet të dëmtohet buxheti në vlerë prej 27,079.80 € pa ndonjë arsye konkrete.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk ka pasur konsideratë edhe nenin 1 të LPP-se, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën me efikasë, me transparente dhe me të drejtë të shfrytëzimit të fondeve

publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove. Andaj duke u bazuar ne faktet e larte permendura AK-ja ka mundur eventualisht te kërkoj sqarime shtese ne baze te dispozitave te nenit 59.2 i cili parasheh qarte se: "Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilin do nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues".

Eksperti i OSHP-se, sqaron se AK e ka obligim ti zbatoj kriteret e kërkuara ne FDT dhe NJK dhe te vlerësoj ofertën sipas nenit 59 te LPP-së, dhe njëkohësisht te zbatohet neni 1,6 dhe 7 te LPP-se dhe t'i respektoj kriteret e kërkuara nga vet AK si një NJK dhe FDT..

Përgjigje nr.4

Lidhur me pretendimin e OE ankues tek lista e mjeteve, OE i rekomanduar për kontrate është i përgjegjshëm edhe për faktin se te makineria tek pika 6- Demolimi i bubëzave ekzistuese dhe skajoreve, kjo kompani ka vendosur një kompresor ajri qe normalisht nuk është sipas kërkesës se dosjes se tenderit sepse është dashur te vendoset ekskavator qe i demonton anësoret ekzistuese, prandaj duke pasur për baze edhe këtë dëshmi atëherë rezulton se oferta e OE se rekomanduar për kontrate, nuk është ne përputhshmëri me kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate, prandaj duhet te eliminohet si oferte e papërgjegjshme.

Ne këtë pike AK te kërkoj sqarime sipas listës se prezantuar, ne piken 6 te Aneksit nr. 7 citim: Demolimi i bubëzave ekzistuese dhe skajoreve.

OE i rekomanduar ne dosjen e tij, ka disa pajisje për piken 6 - Demolimi i bubëzave ekzistuese dhe skajoreve?. Ky kriter është term i zgjeruar, qe nuk e len mundësi qe te precizohet pajisja, por si demolim i bubëzave ekzistuese dhe skajoreve, qe AK-ja e ka kërkuar ne FDT dhe NJPK, por komisioni i vlerësimit, si komision profesional i komunës i ka vërtetuar pajisjet sipas kriterit dhe pajisjeve te bashkangjitura ne dosjen e tij dhe komisioni e ka vlerësuar se është plotësimi i kriterit (pasi qe ky kriter është kërkuar nga vet AK-ja), dhe me këtë vlerësim AK është përgjegjës.

OE i rekomanduar ne dosjen e tij ka bashkangjitur një pajisje (vakum) ngjitës për anësore te betonit sipas DUD-it, ka te bashkangjitur makinën sipas DUD-it qe e kemi cekur me larte.

Pajisje vakum ngjitës i anësoreve te betonit, marka: Jumbo BV , viti 2001, me peshe 520 kg dhe është ne emër te NPT. "GLOBI M.I" – Gjilan, po ashtu ka te bashkangjitur kompresor, ekskavator qe sipas termit nuk e precizon decidivisht çka ka kërkuar AK-ja, por kriteri është i zgjeruar.

Pra, OE i rekomanduar sipas kriterit të AK-se dhe sipas vlerësimit të komisionit profesional të vlerësimit, mendojmë se e plotëson këtë pajisje sipas përshkrimit të DUD-it.

Përderisa nuk është precizuar saktë pajisja atëherë OE nuk mund të eliminohen për një kërkesë e cila nuk është përcaktuar në dosje të tenderit sepse bie në kundërshtim me nenin 56. 3të LPP.

Pretendimi ankimor i pabazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelitshqyrtues që ankesa të aprovohet pjesërisht e bazuar, të mbetet në fuqi vendimi i AK-së, pasi që OE ankues nuk e ka validitetin sipas kërkesës së AK-se 90 dite, por OE ankues e ka vendosur validitetin në FDT 60 dite, që nuk e plotëson kriterin e kërkuar të FDT-se.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 25.09.2020 me raportin e ekspertizës.

Operatori Ekonomik, me datë: 26.09.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues dhe jep sqarimin si më poshtë:

Për OSHP-ë

Datë 26.09.2020.

Nga Bejta Commerce sh.a.

Me datë 25.09.2020 kemi marrë një email në lidhje me mendimin e ekspertit të jashtëm të caktuar nga OSHP për të dhënë mendim mbi ankesën tonë në lidhje me rastin e tenderit me titull:

Ndërtimi i tregut dhe parkut në Zhegër. Numri i Prokurimit: 651-20-3398-5-2-1.

Të nderuar pasi që e kemi lexuar me kujdes mendimin e ekspertit dhe e kemi vlerësuar në të gjitha ato që ka shkruar, mendojmë se:

1. Eksperti nuk ka dhënë mendim profesional dhe të pa anshëm.
2. Ka analizuar dhe ka dhënë përgjigjeje që dyshojmë se janë të ndikuara.
3. Çdo pikë dhe fakt që e kishte në ankesë nuk e ka lexuar për të analizuar por e ka lexuar duke u përpjekur se si ta kundërshtoj sa më lehtë dhe me sa më pak fjalë.

Po i radhisim sipas asaj radhitje që e ke bërë gjatë ekspertizës eksperti:

1. Sa i përket validitetit të ofertës që ne e kemi sqaruar qartë se ka qenë gabim teknik, eksperti thotë se „Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet dhe operatori duhet të eliminohet automatikisht”

Të nderuar validiteti i ofertës duhet vetëm deri sa të vlerësohet tenderi dhe nëse kemi dorëzuar tenderin me datë **24.07.2020**, e pranojmë që e kemi bërë një gabim teknik gjatë shënimit në rubrikën e validitetit të ofertës duke e shënuar gabimisht në vend të 90 ditë, 60 ditë. Të nderuar ja kemi sqaruar komisionit vlerësues se ka qenë gabim teknik dhe e kemi pranuar se jemi të gatshëm që ta përmirësojmë sepse nuk na ka kushtuar as financiarisht e as nuk na ka marrë kohë më shumë që ta shënojë 90 si ka qenë kërkesa, prandaj kjo jep me kuptim se ka qenë gabim teknik dhe si i tillë nuk e ka dëmtuar sa pak as AK e as dikë tjetër.

Eksperti në këtë rast mendojmë se është dashur të merret më shumë me kriterin që ka qenë i vendosur në tender e që ka qenë: Kriteret e Dhënies-pika 30.1- Çmimin më të ulët, sepse nuk mund të anashkalohet kriteri kryesor i vendosur nga vetë autoriteti për një gabim teknik e që ka mund të përmirësohet me një kërkesë për vazhdim të validitetit, e kërkesa të tilla AK bëjnë pothuajse në çdo të dytin tender dhe po të ishte e kundërligjshme sigurisht që nuk do ta bënin dhe për rrjedhojë nuk mund të jetë e kundërligjshme si veprim në një rast e në rastin tjetër të jetë e lejuar.

Si ekspert të mos e marrësh parasysh se po dëmtohet buxheti i një komune për shumën 27.097.80 euro dhe të mos e analizosh as edhe në një rast të vetëm gjatë ekspertizës duke e ditur që ka qenë kriteri kryesor për dhënie të kontratës për mua është e habitshme dhe kjo më bën të dyshoj se mendimi ka qenë i ndikuar.

Tenderi është dorëzuar me datë 24.07.2020 dhe vlerësimi është bërë 14.08.2020 që i bie saktësisht 22 ditë kalendarike dhe oferta jonë edhe pse me gabim teknik ka pasur validitet të plotë edhe për plot 38 ditë dhe pa e vazhduar fare ka mund të vendoset sepse ligji i prokurimit e përcakton qartë të: *RREGULLAT DHE UDHËZUESI OPERATIV PËR PROKURIMIN PUBLIK*

31. Validiteti i Tenderit

31.1. Autoritetet kontraktuese duhet të cekin në dosjen e tenderit periudhën e vlefshmërisë së tenderit të kërkuar dhe të specifikuar si numër i ditëve kalendarike nga afati i fundit për dorëzimin e tenderëve.

31.2 Kërkesa për periudhë të validitetit të tenderit do të jetë:

- Në minimum 90 ditë për kontrata me vlerë të madhe;
- Në minimum 60 ditë për kontrata me vlerë të mesme; dhe
- Në minimum 30 ditë për kontrata me vlerë të vogël.

Periudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshojë varësisht nga

kompleksiteti i prokurimit. Periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës.

31.3 Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre.

Kërkesa për zgjatje të validitetin të

tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit).

31.6 Është e hapur për secilin OE të vendosë nëse dëshiron të përtërijë validitetin e tenderit apo jo. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si "të papërgjegjshëm"¹ dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre. Pra duke u nisur nga këto rregulla që i parasheh ligji gjegjësisht nga pika 31.3 që thotë: Periudha e

kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës. dhe

31.4 që thotë Nën situata të justifikueshme AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Për mendimin tim nuk mund të ketë situatë me të justifikueshme sesa kur është në pyetje ruajtja e buxhetit të Komunës. Dhe këto dy pika e përcaktojnë qartë se nuk është e ndaluar të kërkojë një apo të gjithë operatorëve vazhdimin e validitetit si në këtë rast kur kriter kryesor nuk e ke pas validitetin e ofertës por çmimin me të ulet.

Te përgjigjja në piken 2.

Eksperti thotë se sa i përket inxhinierit të gjeodezisë që është përdorur i njëjti nga të dy palët nuk e paska gjetur të shkruar në kërkesat e FDT se nuk kanë të drejtë që dy kompani ta përdorin të njëjtin inxhinier, nuk e ka gjetur dhe nuk do ta gjej kurrë të shkruar në dosje të tenderit sepse e përcakton saktë ligji i punës se si krijohet një marrëdhënie pune dhe se kur ka mundësi që një person me kontratë të rregullt ta ketë dhe një kontratë për punë dhe detyra specifike, prandaj nuk e ka gjetur dhe nuk do ta gjej kurrë të shkruar në dosje të tenderit. Në rastin konkret kërkesa ka qenë: Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional dhe teknik të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme :

Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë apo bachelor me min dy (2) vite përvojë pune pas diplomimit.

Dhe në asnjë pikë nuk ka qenë e cekur që mund të angazhohet me kontratë për punë dhe detyra specifike por edhe sikur të ishte e cekur nuk mund të ja marrësh punëtorin dikujt që e ka me vite të punësuar

me kontratë të rregullt, të çilen e kemi dëshmuar me të gjitha pagesat e marrura nga ATK për tatimi që i është paguar që nga 2017 e deri me tani si punëtor i rregullt. Një veprim i tillë nga operatori tjetër do të duhej të ishte vërtetë menjëherë nga komisioni vlerësues dhe nuk do të duhej të ishte toleruar sepse nuk mund ta krahasosh rëndësinë e një kontrate specifike me një kontratë të rregullt.

Te përgjigjja në pikën 3.

Në analizimin e kësaj pike sipas mendimit tim ekspertit nuk e ka pasur parasysh fare se kriteri për dhënie të kontratës ka qenë çmimi me i ulët dhe tërthorazi i është shmangur analizimit korrekt sepse kur ekziston i vendosur si kriter çmimi me i ulët gjitha të tjerat janë dytësore dhe nuk mund të kalohet kriteri i lartë cekur pa u bërë të gjitha përpjekjet e lejuar me ligje që të vendoset sipas këtij kriteri.

Te përgjigjja në pikën 4.

Eksperti në këtë pikë, që ka qenë kërkesa me numër 6-Demolimi i bubëzave dhe skajoreve thotë se nuk përbën problem pasi që nuk ka qenë e specifikuar qartë se çfarë makine do duhej vendosur sepse thotë ekspertit, është term i zgjeruar.

Të nderuar ky nuk është term i zgjeruar por është term inegzisten në terminologjinë e makinerisë sepse nuk ka një makinë që mund të quhet me këtë emër dhe paraprakisht kam bërë kërkesë me kohë gjatë mundësisë për sqarim të dosjes së tenderit që të largohet ose të specifikohet se çka kanë dashtë me than me këtë term, por nuk kam marrë përgjigjeje dhe në tender kam vendosur një ekskavator që realisht e bënë demelimin dhe largimin e bubëzave dhe skajoreve. Por të thuash që edhe vendosja e një kompresori të ajrit si makineri për demelimin e anësoreve është vlerësuar si e lejueshme nga komisioni vlerësues që ekspertit thotë se ka qenë profesional, për mua është e pa pranueshme sepse kompresori i ajrit nuk bën asgjë tjetër përveç se prodhon ajër dhe për pasojë nuk ka mundësi të demolojë anësore as kupëza betoni. Kriteri paraprakisht kam pasur dyshimet se ka qenë i vendosur me qëllim të krijoi konfuzion dhe është dashur të largohet kur e kam bërë kërkesën e parë në afatin e sqarimit të dosjes së tenderit

Pra e nderuar OSHP për ne, mendimi i ekspertit është i pa pranueshëm dhe qartë len hapësirë për dyshime se ka qenë i ndikuar dhe si të tillë nuk mund ta pranojmë.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 08.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të

prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaro se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e pare ankimor lidhur me validitetin e ofertës siç është kërkuar në FDT dhe NJPK është se Validiteti i ofertës të jete 90 dite, kurse OE ankues në dosjen e tij e ka shënuar 60 dite, që bie ndesh me kriterin e kërkuar të AK-se.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se neni 31 i RRUOPP-se e precizon Validitetin e tenderit

Paragrafi 31.1 Autoritetet Kontraktuese duhet të cekin në dosjen e tenderit periudhën e vlefshmërisë së tenderit të kërkuar dhe specifikuar, si numër i ditëve kalendarike, nga afati i fundit për dorëzimin e tenderëve.

31.2 Kërkesa për periudhën e validitetit të tenderit do të jete:

- Minimum 90 dite për kontrata me vlera të mëdha;
- Minimum 60 dite për kontrata me vlera të mesme;
- Minimum 30 dite për kontrata me vlera të vogël.

Pra, kriteri i kërkuar i AK-së ka qenë 90 dite, kurse OE e ka sjellë validitetit 60 dite, që nënkuptohet se nuk është përmbushur kriteri i kërkuar i AK-së si në FDT dhe NJK.

Pra, edhe neni 39.8 i RRUOPP-se thotë:

Formulari i tenderit, nuk është plotësuar siç duhet apo mungon – Refuzo tenderin pa kërkuar sqarim shtesë – kusht administrativ.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, lidhur me inxhinierin e gjeodezisë z. Izjadin Syla, ky inxhinier është i prezantuar në dosjet e të dy OE-ve (fituesit dhe ankuesit).

Pra, në dosjet e dy kompanive OE ankues BEJTA COMMERCE dhe OE i rekomanduar GLOBI M.I, vërehet se dy OE-te e kanë inxhinierin e njëjtë.

Paneli shqyrtues konstaton se merastin e rivlerësimit AK duhet ta verifikoj këtë pretendim dhe të vërtetohet se inxhinieri në fjalë në cilën kompani punon, të kërkohet sqarime në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së

dhe te vijnë ne përfundim se cili nga këta operator ekonomik plotëson kërkesën e AK-së, lidhur me inxhinierin e gjeodezisë

Lidhur me pretendimin ankimor për mos respektim te nenit 1,7 te LPP-se, Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 te LPP-se, sepse janë obliguar qe te sigurohen qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrë me ekonomike, njëkohësisht duke marr ne konsiderate qëllimin dhe lenden e prokurimit. Prandaj, me këtë veprim te AK-se po rrezikohet te dëmtohet buxheti ne vlere prej 27,079.80 € pa ndonjë arsye konkrete.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk ka pasur konsiderate edhe nenin 1 te LPP-se, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroje mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove. Andaj duke u bazuar ne faktet e larte përmendura AK-ja ka mundur eventualisht te kërkoj sqarime shtese ne baze te dispozitave te nenit 59.2 i cili parasheh qarte se: "Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilin do nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues".

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues konstaton, se AK e ka obligim ti zbatoj kriteret e kërkuara në FDT dhe NJK dhe te vlerësoj ofertën sipas nenit 59 te LPP-së, dhe njëkohësisht te zbatohet neni 1,6 dhe 7 te LPP-së dhe t'i respektoj kriteret e kërkuara nga vet AK si një NJK dhe FDT.

Lidhur me pretendimin e OE ankues tek lista e mjeteve, OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm edhe për faktin se te makineria tek pika 6- Demolimi i bubëzave ekzistuese dhe skajoreve, kjo kompani ka vendosur një kompresor ajri qe normalisht nuk është sipas kërkesës se dosjes se tenderit sepse është dashur te vendoset ekskavator qe i demonton anësoret ekzistuese, prandaj duke pasur për baze edhe këtë dëshmi atëherë rezulton se oferta e OE se rekomanduar për kontrate, nuk është ne përputhshmëri me kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate, prandaj duhet te eliminohet si oferte e papërgjegjshme.

Ne këtë pike AK te kërkoj sqarime sipas listës se prezantuar, ne piken 6 te Aneksit nr. 7 citim: Demolimi i bubëzave ekzistuese dhe skajoreve.

Paneli shqyrtues konstaton, se me rastin e rivlerësimit te verifikohet dëshmitë e ofruara për piken 6 te aneksi nr. 7 te FDT-së dhe te vërtetohet se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës a ka ofruar dëshmitë sipas kresës se AK-së. Paneli shqyrtues sqaron se OE nuk mund të eliminohen për një kërkesë e cila nuk

është përcaktuar në dosje të tenderit sepse bie në kundërshtim me nenin 56. 3të LPP, andaj duhet te merret ne konsideratë edhe ky nen me rastin e rivlerësimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 /AK/ - "KK-Gjilan" (KK.GJ),
- 1x1 / OE/ - "Bejta Commerce" SH.P.K – Gjilan,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.